



Në bazë të nenit 21, 22, 44 dhe 50 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 17, pika “d” të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, duke vendosur sipas detyrës zyrtare, me datë 24.09.2021, merr këtë:

V E N D I M

PËR KORRIGJIMIN E AKTIT ADMINISTRATIV “VENDIM PËR KAKTIMIN E
 KUSHTEVE NDËRTIMORE” 05 NR. 350/02-65677/21 DT. 22.07.2021

I. Korrigjohet akti administrativ “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore” 05 Nr. 350/02-65677/21 dt. 22.07.2021, i kësaj drejtorie, i lëshuar në emër të aplikuesve Edon Kelmendi, Drilon Kelmendi, Fisnik Kelmendi, Sadedin Sharku dhe Avni Zeqiri nga Prishtina, dhe investitorit “Uni Projekt” shpk, me seli në Prishtinë, me numër unik identifikues 811253905, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesë shumë banesore dhe afariste – “Ndërtesa 1”, me etazhitet -2B+P+10, në kuadër të bllokut urban “A15”, të tërësisë hapësinore “A” të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Qendër” në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1678-0 ZK Prishtinë.

Korrigjimi bëhet në:

- *Pikën I. I caktohen kushtet ndërtimore, të dispozitivit të aktit administrativ të referuar, te pjesa e shënimit të numrit të parcelës kadastrale, dhe atë, në vend të “...nr. 1678-0” duhet të shënohet “...nr. 1678-1”;*
- *Pikën X. Pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, të dispozitivit të aktit administrativ të referuar, te pjesa e shënimit të zonës kadastrale ku evidentohet parcela kadastrale nr. 1678-1, dhe atë, në vend të “...ZK Matiçan” duhet të jetë “...ZK Prishtinë”.*

II. Ky vendim është pjesë e aktit administrativ “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore” 05 Nr. 350/02-65677/21 dt. 22.07.2021, dhe i njëjti do të prodhojë efekt juridik nga dita e miratimit të tij.

A r s y e t i m

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, me aktin administrativ “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore” 05 Nr. 350/02-65677/21 dt. 22.07.2021, u ka caktuar kushtet ndërtimore aplikuesve Edon Kelmendi, Drilon Kelmendi, Fisnik Kelmendi, Sadedin Sharku dhe Avni Zeqiri nga Prishtina, dhe investitorit “Uni Projekt” shpk, me seli në Prishtinë, me numër unik identifikues 811253905, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesë shumë banesore dhe afariste – “Ndërtesa 1”, me etazhitet -2B+P+10, në kuadër të bllokut urban “A15”, të tërësisë hapësinore “A” të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Qendër” në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1678-0 ZK Prishtinë.

Në ndërkohë, ky organ ka vërejtur se në aktin administrativ të referuar, kanë rrjedhur dy gabime teknik, gjegjësisht në pikën I dhe X të dispozitivit të të njëjtit akt, është shënuar gabim numri i parcelës kadastrale, përkatësisht emri i zonës kadastrale, ku të njëjtat duhet të jenë nr. 1678-1 ZK Prishtinë, dhe sipas detyrës zyrtare, pas rishikimit të aktit të referuar dhe konstatimit për gabimet e rrjedhura, të njëjtat korrigjohen, sipas përshkrimit në pikën I të dispozitivit të këtij akti.

Bazuar në dispozitat ligjore të përmendura, ky organ vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim u printua në 4 (katër) kopje identike dhe i dërgohet: Aplikuesve/Investitorit, në dosje të lëndës 05 Nr. 350/02-65677/21 dt. 12.04.2021, kësaj drejtorie dhe Qendrës për shërbim me qytetarë.

Kopja elektronike i dërgohet: Drejtorisë së Pronës, Drejtorisë së Kadastrit dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 350/02-65677/21 DT. 24.09.2021**

Zyrtari,
Nazife Krasniqi

U.D. Udhëheqëse e Sektorit,
Mimoza Berisha Prestreshi

Drejtori,
Arifan Olluri

